

Vendim nr. 153 datë 03.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 03.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (O) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ODETA ALIRAJ,
ARTAN HARIZAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1242 (226), datë 25.07.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 29, pika 3, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi A.B. ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*Prokuroria Vlorë*) kundër shtetasit Artan Haziraj, për kryerjen nga ky i fundit të veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP), për të cilin është regjistruar procedimi penal me nr. 113 të vitit 2012. Në datën 11.06.2012 Prokuroria Vlorë ka vendosur pushimin e çështjes penale me arsyetimin se edhe pse dokumenti ishte i falsifikuar, nuk arrihej të provohej dijenia e kërkuesit për falsitetin e tij ose të identifikohet personi që kishte paraqitur të dhënat e rreme. Po kështu, kishin kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, ndaj ajo nuk mund të vazhdonte.

2. Në datën 02.07.2012 drejtuesi i Prokurorisë Vlorë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale, duke urdhëruar riformulimin e tij në pjesën arsyetuese. Në datën 24.07.2012 prokurori i çështjes ka vendosur sërish pushimin e saj, me arsyetimin se falsiteti i dokumentit nuk mund të provohej, pra nuk provohej ekzistenca e kryerjes së veprës penale. Në vijim, drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të datës 24.07.2012, duke urdhëruar vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve.

3. Në datën 06.12.2012 shtetasi G.B. ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasve Artan Harisi dhe Odeta Aliraj, bashkëjetuese e tij, për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Për kallëzimin e bërë, Prokuroria Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. 1939 të vitit 2012 dhe në datën 14.01.2013 është vendosur bashkimi i këtij procedimi me atë nr. 113 të vitit 2012 në një procedim penal të vetëm të numërtuar nr. 113 të vitit 2012. Në vijim, në datën 08.02.2013 Prokuroria Vlorë ka shënuar emrat e shtetasve Artan Haziraj dhe Odeta Aliraj (*kërkuesit*) si persona të cilëve u është atribuar kryerja e veprës penale. Dy nga prokurorët e caktuar për çështjen kanë hequr dorë, duke u bërë zëvendësimi i tyre me tjetër prokuror, ndërsa me vendime të këtij të fundit është vendosur zgjatja disa herë e afatit të hetimeve.

4. Në datën 14.11.2013 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë ka referuar për kompetencë në Prokurorinë Vlorë procedimin penal të regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit A.B. ndaj kërkuesve për veprën penale të parashikuar nga neni 186, paragrafi i tretë, i KP-së. Ky procedim është regjistruar në Prokurorinë Vlorë në datën 30.12.2013 me nr. 1505. Në vijim, në datën 30.12.2013 është vendosur bashkimi i këtij procedimi me procedimin penal nr. 113 të vitit 2012 në një të vetëm, të numërtuar me nr. 113 të vitit 2012. Me vendimet e Prokurorisë Vlorë të datave 06.05.2014 dhe 06.07.2014 është vendosur zgjatja e afatit të hetimeve respektivisht deri në datat 06.07.2014 dhe 06.08.2014.

5. Në datën 21.07.2014, bazuar në nenet 324 e 325 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për kundërshtimin e vendimit të zgjatjes së afatit të hetimeve, ndërprerjen e hetimeve dhe pushimin e çështjes, duke pretenduar se vendimi i Prokurorisë Vlorë për zgjatjen e afatit të hetimit nga data 06.07.2014 deri në datën 06.08.2014 ishte absolutisht i pavlefshëm, për shkak se ishte bërë tej afatit hetimor. Sipas tyre, hetimi i procedimit penal nr. 113 të vitit 2012 kishte zgjatur më shumë se 2.5 vjet dhe nuk u ishte komunikuar. Në këto kushte, hetimi duhej të pushonte, pasi çdo veprim tjetër hetimor do të ishte jashtë afatit hetimor dhe zgjatjes së këtij afati. Organi i prokurorisë ka pretenduar se vendimet e prokurorit për zgjatjen e hetimeve ishin miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe se ato u ishin komunikuar kërkuesve.

6. Me vendimin nr. 344 (61-2014-2454), datë 31.07.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se çështja ishte komplekse dhe se organi i akuzës kishte arritur të argumentonte vështirësitë dhe pamundësinë objektive për kryerjen në mënyrë korrekte, të shpejtë dhe të dejtë të veprimeve hetimore. Bazuar në ankimin e kërkuesve, me vendimin nr. 200, datë 18.12.2014, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 06.07.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. 113 të vitit 2012, duke arsyetuar, ndër të tjera, se nga data 30.03.2014 veprimtaria hetimore e prokurorit ishte kryer jashtë afatit të hetimit të çështjes penale dhe çdo veprim i mëtejshëm, pas kësaj date, i ndryshëm nga ato që dispononte ligji, ishte i papërdorshëm në kuptim të pikës 4 të nenit 324 të KPP-së. Për rekursin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin nr. 00-2015-2922, datë 26.11.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin.

7. Ndërkohë, në datën 30.07.2014 Prokuroria Vlorë ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të kërkuesve. Gjatë fazës së kërkesave paraprake, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkuesit kanë pretenduar pavlefshmërinë e akteve të veprimeve hetimore, konkretisht: të vendimit për marrjen si të pandehur; të procesverbalit të njohjes së tyre, në cilësinë e të pandehurve, me çështjen; të vendimit për dërgimin e çështjes në gjyq; të kërkesës për gjykimin e procedimit penal. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 237, datë 28.04.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pranimin e kërkesës së të pandehurve për pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e këtyre akteve dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të tyre. Sipas gjykatës, në kushtet kur me vendimin e formës së prerë nr. 200, datë 18.12.2014 Gjykata e Apelit Vlorë kishte konkluduar se veprimet hetimore të kryera nga prokuroria pas datës 30.03.2014 ishin të pavlefshme, çka i bënte aktet e nxjerra pas kësaj

date të papërdorshme, asaj nuk i ngelej tjetër veçse të konstatonte konkluzionet e gjykatës së apelit dhe të vendoste në përputhje me to. Në këto kushte, ndjekja penale nuk mund të vazhdonte dhe çështja penale në ngarkim të kërkuesve duhej pushuar.

8. Ndaj vendimit nr. 237, datë 28.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ushtruar ankim prokuroria pranë kësaj gjykate, ndërsa kërkuesit kanë paraqitur apel kundërshtues. Me vendimin nr. 298, datë 20.04.2017, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Sipas kësaj gjykate, pavarësisht se shkak i pushimit të çështjes, pavlefshmëria absolute e akteve procedurale, duhej t'i referohej pjesës arsyetuese të vendimit të gjykatës së rrethit, duke lënë si dispozitiv vetëm disponimin në lidhje me pushimin e çështjes penale, vendimi i kësaj gjykate ishte i drejtë e i bazuar në ligj dhe një disponim i tillë i saj nuk cenonte thelbin e vendimmarrjes.

9. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs prokuroria, ndërsa kërkuesit kundërrekurs. Me vendimin nr. 00-2023-1242 (226), datë 25.07.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 298, datë 20.04.2017 të Gjykatës së Apelit Vlorë e nr. 237, datë 28.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (gjyqtari i seancës paraprake).

10. Në datën 20.05.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesve

11. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

11.1. *Parimit të sigurisë juridike në lidhje me pritshmëritë e ligjshme*, pasi pavlefshmëria dhe papërdorshmëria e akteve të procedimit penal të iniciuar ndaj tyre ishte zgjidhur përfundimisht me vendimin nr. 200, datë 18.12.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë, të lënë në fuqi me vendimin nr. 00-2015-2922, datë 26.11.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Ndonëse këto akte janë deklaruar të pavlefshme dhe të papërdorshme me vendim të formës së prerë, Gjykata e Lartë ka gjykuar edhe një herë për to, duke i bërë të vlefshme përmes interpretimit të saj, pavarësisht se ishin hartuar pas afatit maksimal 2-vjeçar të hetimit, pa qenë zgjatur ky afat sipas procedurës ligjore. Në këtë mënyrë, në

keqinterpretim subjektiv, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme, sipas të cilit një individ nuk mund të rrijë me frikë se çështja e tij mund të hapet jashtë kritereve ligjore.

11.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme e caktuar me ligj*, pasi interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë nenit 324, pika 4, të KPP-së është në tejkalim të kuptimit dhe përcaktimit të vetë ligjit, si dhe vendimeve unifikuese të saj. Ky interpretim është bërë me dashakeqësi e në rëndim të pozitës së kërkuesve.

11.3. *Parimit të ligjshmërisë*, pasi, qoftë për sa i përket themelit të çështjes, ashtu edhe për sa i përket mënyrës së disponimit, Gjykata e Lartë nuk i është referuar ligjit në fuqi në momentin e shqyrtimit të çështjes, por dispozitave aktuale në fuqi. Kjo gjykatë ka vendosur kthimin e çështjes për shqyrtim gjyqtarit të seancës paraprake, ndërkohë që dispozitat që përcaktojnë institutin e gjyqtarit të hetimeve paraprake, procedurën gjyqësore të seancës paraprake ose vendimmarrjen e seancës, sipas kësaj procedure, nuk kanë qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes nga gjykata e rrethit. Sipas nenit 331 të KPP-së, në fuqi në momentin e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, prokurori vendoste dërgimin e çështjes në gjyq dhe gjykata vendoste për themelin e saj, por gjykata nuk kishte të drejtë t'i kthente çështjen prokurorit për plotësimin e hetimeve.

11.4. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, si rrjedhojë e disponimit të Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për shqyrtim gjyqtarit të seancës paraprake, çka ka rënduar pozitën procedurale të kërkuesve, pasi ka kthyer çështjen në një fazë që ishte kaluar tashmë. Përkeqësimi juridik e procedural i pozitës së tyre lidhet me kompetencat e ndryshme ligjore që ka pasur gjykata në seancë gjyqësore, sipas ligjit të kohës, gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit, të ndryshme nga ato që, sipas ligjit aktualisht në fuqi, ka gjyqtari i hetimeve paraprake në seancë paraprake. Kështu, sipas ligjit të kohës, por edhe aktualisht, gjykata në seancë gjyqësore vendos për themelin e çështjes, konkretisht për fajësinë, pafajësinë ose pushimin e çështjes, ndërsa në seancë paraprake mund të vendosë edhe kthimin e çështjes për plotësimin e hetimeve. Kjo i jep kohë prokurorit të grumbullojë prova në favor të akuzës e në dëm të të pandehurve, duke i dhënë gjykatës rol aktiv dhe duke e nxjerrë atë nga roli i saj i arbitrit të paanshëm. Nga ana tjetër, neni 441, pika 1, shkronja “ç”, i KPP-së, mbi të cilin është mbështetur

Gjykata e Lartë për marrjen e vendimit, nuk parashikon kthimin e çështjes për rigjykim në seancë paraprake, por në seancë gjyqësore. Vendimi i kalimit të çështjes për gjykim është i paankimueshëm, sipas nenit 332/gj, pika 1, të KPP-së. Në këto kushte, Gjykata e Lartë duhej të kishte vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në seancë gjyqësore dhe jo në seancë paraprake.

11.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi ndonëse shprehet se gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar me hollësi për papërdorshmërinë dhe pavlefshmërinë e akteve dhe se kanë ngatërruar këto dy koncepte, Gjykata e Lartë nuk e ka arsyetuar vendimin gjyqësor në drejtim të pretendimeve të ngritura nga kërkuesit në kundërrekurs dhe qëndrimeve që ajo vetë ka mbajtur. Në kundërrekurs ata kanë pretenduar se prokuroria e apelit nuk mund të shqyrtojë themelin e pavlefshmërisë së akteve të hetimeve paraprake për të cilat është vendosur me vendim të formës së prerë dhe as t'i ankimojë ato, ndërkohë që në vendim Gjykata e Lartë nuk ka dhënë argumente se përse nuk i ka marrë parasysh këto pretendime. Ajo nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar se përse e quan të pabazuar vendimin e gjykatës së apelit dhe nuk ka marrë parasysh vendimet unifikuese të saj për elementet e pavlefshmërisë dhe papërdorshmërisë së akteve. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka sqaruar ndryshimin ndërmjet këtyre dy termave dhe në kushtet kur nuk i ka pasur të qarta ato, duhej të kishte bërë njësimin e praktikës gjyqësore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesve

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në

mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kërkuessit, si individ, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 25.07.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është depozituar në postë në datën 20.05.2024.

16. Në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, pra nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, është data në të cilën vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimet nr. 42, datë 29.05.2024; nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, sipas informacionit të vënë në dispozicion të Gjykatës në rrugë elektronike nga Gjykata e Lartë, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar nr. 00-2023-1242 (226), datë 25.07.2023 i kësaj të fundit është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 23.11.2023, datë në të cilën palët mund ta dispononin atë. Ndërkohë, sipas shënimit të shërbimit postar, kërkesa drejtuar Gjykatës është depozituar në postë në datën 20.05.2024, pra pothuajse 6 muaj pas bërjes së vendimit të disponueshëm për palët. Në lidhje me këtë, kërkuessit kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk u është komunikuar në një nga format e përcaktuara nga ligji, se kanë marrë dijeni për të në datën 19.01.2024, kur u është komunikuar

fletëthirrja për t'u paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe se kanë marrë kopje të tij në datën 30.01.2024, kur kanë bërë pagesat përkatëse për tërheqjen e vendimit nga gjykata.

18. Nga materialet e depozituara së bashku me ankimin kushtetues individual, Kolegji evidenton se kërkuesit kanë qenë në dijeni të vijueshmërisë së procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, pasi kanë paraqitur kundërrekurs ndaj rekursit të prokurorisë. Po kështu, krahas nënshkrimit të kërkuesve, në cilësinë e palëve në gjykim, kundërrekursi përmban edhe nënshkrimin e kërkueses Odeta Aliraj, në cilësinë e përfaqësueses së tyre ligjore. Në këtë kuptim, nisur nga fakti se kërkuesit kanë qenë në dijeni për gjykimin e çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë, si dhe janë përfaqësuar me mbrojtës përpara kësaj gjykate, Kolegji çmon se ata kishin detyrimin për të ndjekur ecurinë e çështjes në këtë gjykatë, përfshirë publikimin e vendimit të kundërshtuar në faqen zyrtare të gjykatës.

19. Po në këtë drejtim, Kolegji vëren se neni 485/b i KPC-së "*Njoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë*" parashikon se sekretaria gjyqësore njofton vendimet e Gjykatës së Lartë sipas nenit 316 të këtij kodi, ndërsa paragrafi 2 i këtij të fundit referon në nenet 128 e vijues të KPC-së, që përcaktojnë mënyrat e njoftimit të akteve, ndër të cilat, neni 141 i KPC-së parashikon edhe atë të njoftimit elektronik. Bazuar në këtë dispozitë, si dhe në kompetencat e parashikuara në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", me urdhrin nr. 131, datë 02.07.2021 "*Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve*", zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate për njoftimin në rrugë elektronike të palëve për të tria llojet e gjykimeve para saj, konkretisht ato administrative, civile dhe penale (*shih pikën 5 të këtij urdhri*).

20. Referuar detyrimeve që përcaktojnë këto akte, si dhe jurisprudencës së Gjykatës, Kolegji evidenton se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuesit nuk kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit të tyre ose përfaqësueses ligjore, ndaj, në këtë këndvështrim, çmon se mosnjoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk është rrjedhojë e veprimeve të sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate, por e mangësive në veprimet e vetë kërkuesve. Nga ana tjetër, në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesit nuk kanë parashtruar ndonjë shkak pamundësie për t'u njohur më parë me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë.

21. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji çmon se kërkuesit nuk legjitimohen *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

22. Në kushtet kur kriteri paraprak i parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000 nuk plotësohet, Kolegji çmon se analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual të kërkuesve bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret paraprake për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.